



Mentorimi kolegjal në arsim

Qëllimi i programit:

Ky modul ofrohet është dizajnuar me mbështjete e projektit EU IPA 2009 "Trajnimi i mësimitdhënësve dhe ndërtimi i kapaciteteve të komunave dhe drejtorë të shkollave" i financuar nga BE menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (ZBE) dhe zbatuar në emër të MASHT-it nga GIZ IS. Në kuadër të marrëveshjes së Fakultetit të Edukimit/IHZHA është paraparë ofrimi i trajnimeve për zhvillim profesional të mësimitdhënësve dhe ky modul parashihet të ofrohet me qëllim të zhvillimit të kulturës së bashkëpunimit në mes të kolegëve, zhvillimit profesional dhe ngritjes së cilësisë në shkollë.

Grupi i synuar i mësimitdhënësve /vijuesve:

Ky program i dedikohet mësimitdhënësve të klasave 1-12 të të gjitha fushave, gjithashtu edhe studentëve, të cilët janë duke u përgatitur si mësimitdhënës të ardhshëm.

Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim është 15-25.

Rezultatet e programit:

Në fund të punës me module dhe aktivitete tjera mësimitdhënësit do të jenë në gjendje të:

- Analizojnë konceptin dhe procesin e mentorimit si aspekt të zhvillimit profesional në shkollë;
- Dallojnë rolet e mentorit dhe përfitimet nga mentorimi;
- Vlerësojnë rolin e mentorimit kolegjal si proces i pandashëm në ZHPM dhe në ngritjen e cilësisë në mësimitdhënie.
- Identifikojnë shkathtësitë, njohuritë dhe cilësitë që i nevojiten një mentori efektiv;
- Përdorin mentorim mes kolegëve për të përforcuar zhvillimin profesional të mësimitdhënësve;
- Rishikojnë ciklin e reflektimit mbi procesin e mentorimit;